



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit si Mekanizëm parandalues nacional, konform mandatit i cili rrjedh nga Protokolli Fakultativ ndaj Konventës kundër torturës dhe llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues, më datën 16.05.2016 realizoi vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Qendrën Transit „Vinojug”-Gjevgjeli, e cila kishte për qëllim marrjen e pasqyrës reale për realizimin e të drejtave të personave të vendosur në Qendër, ndërkaq të garantuara me ligjet kombëtare dhe aktet ndërkombëtare, sidomos me Konventën e Gjenevës për Statusin e Refugjatëve të vitit 1951.

Gjatë vizitës u realizuan disa takime me zyrtarë të Ministrisë për Punë të Brendshme, Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale dhe Qendrës për menaxhim me kriza, si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe joqeveritare të pranishëm në vendin e ngjarjes (IOM - International organisation for migration), Shoqata maqedonase e juristëve të rinj-(SHMJR), Porta e Hapur-Shoqatë për aksion kundër dhunës dhe tregtisë me njerëz (*La Strada dhe Legis*), të cilat dhanë informata për strukturën e tyre organizative dhe kompetencat funksionale, ndërkaq u realizuan edhe bisedime të drejtpërdrejta me disa persona të vendosur në tendën e „Habitat”-it, e cila është vendosur pranë Qendrës Transit „Vinojug”, të cilët na informuan për trajtimin ndaj tyre dhe pamundësinë e qasjes pranë procedurës për pranimin e të drejtës për azil.

Në këtë kuptim, Mekanizmi parandalues nacional konstatoi se në Qendrën Transit „Vinojug” vazhdimisht janë të pranishëm disa autoritete dhe organizata me përgjegjësi dhe funksione të ndara, të cilat përmes komunikimit dhe koordinimit të përbashkët marrin pjesë në udhëheqjen dhe menaxhimin e qendrës.

Megjithatë nga situata e hasur në terren, Mekanizmi parandalues nacional konstatoi se koordinimi ndërmjet autoriteteve dhe organizatave të përmendura nuk funksionon në nivel më të lartë, duke pasur parasysh se asnjë nga autoritetet dhe organizatat e pranishme nuk arritën të na japin informatë konkrete për ditën e saktë të pranimit të secilit person të vendosur në Qendrën Transit „Vinojug”.

Njëherazi, Mekanizmi parandalues nacional konsideron se është e nevojshme të theksojë edhe faktin se nga ana e përfaqësuesve të Qendrës për menaxhim me kriza hasëm në rezistencë dhe mosbashkëpunim edhe përskaaj sugjerimeve për mandatin

dhe autorizimet e Avokatit të Popullit, pasi që edhe përskej përpjekjeve tona, nuk na i dorëzuan raportet ditore të cilat përfaqësuesit e Qendrës për menaxhim me kriza të pranishëm në vendin e ngjarjes i dërgonin pranë selisë qendrore në Shkup. Rrjedhimisht pas kësaj u realizua kontakti edhe me drejtorin e Qendrës për menaxhim me kriza, i cili na premtoi se të dhënat do t'i dërgojnë në afat sa më të shkurtë, por të njëjtat akoma nuk i kemi pranuar.

Në ditën e vizitës, sipas të dhënave të pranuar nga përfaqësuesit e Ministrisë për Punë të Brendshme, të verifikuara nga evidenca e dokumentuar plotësuese udhëhequr nga ana e IOM-it (International organisation for migration), në Qendrën e përkohshme tranzituese janë strehuar gjithsej 101- (njëqind e një person), prej të cilëve 59 persona nga Siria, 41 person nga Iraku dhe 4 persona janë nga Avganistani.

Të gjithë këta persona kanë arritur në Republikën e Maqedonisë para mbylljes së kufijve edhe në të ashtuquajturën „Rutë Ballkanike”, ndërkaq shumica prej tyre me vendimin e tillë janë gjetur në kufi me Serbinë, për çka, për një kohë kanë qenë të strehuar në Qendrën Transit - „, Tabanovcë”.

Nga bisedimet e realizuara në mënyrë të drejtpërdrejtë, mund të konstatohet se personat e vendosur në suaza të Qendrës Transit - „,Vinojug” janë të këshilluar dhe të njoftuar për mundësinë e paraqitjes së kërkesës për pranimin e të drejtës për azil në Republikën e Maqedonisë dhe se, në çdo kohë për këshilla dhe ndihmë juridike mund t'u drejtohen përfaqësuesve të Shoqatës së juristëve të rinj, të cilët janë vazhdimisht të pranishëm në Qendër.

Për dallim nga Qendra, në tendën e „Habitat”-it, e cila gjendet në afërsi të Qendrës, Mekanizmi parandalues nacional konstatoi gjendje faktike diametralisht të kundërt, e cila pasqyron një menaxhim kaotik i cili nuk përmbush as standardet minimale për strehim të përkohshëm.

Tendi i „Habitat”-it konform vizitave të mëparshme në terren ka shërbyer për strehim (vend për pritje) të migrantëve para hyrjes në Qendrën Transit - „, Vinojug”, ndërsa kohët e fundit i njëjti shfrytëzohet për qëllime tjera, përkatësisht për strehim të përkohshëm, afatshkurtë të personave të cilët kanë hyrë në mënyrë jolegale në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Gjatë ditës së vizitës në tend ishish strehuar 84 - (tetëdhjetë e katër persona), por sipas informatave të pranuar ky numër vazhdimisht ndryshon, duke pasur parasysh se strehimi i tyre është i karakterit të përkohshëm dhe afatshkurtë (më së shpeshti 12-dymbëdhjetë deri më 15-pesëmbëdhjetë orë) dhe zgjatë deri në deportimin e tyre të sërishëm në shtetin prej të cilit kanë hyrë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Brengos fakti se këta persona fare nuk janë njoftuar që kanë mundësi të paraqesin kërkesë për pranimin e të drejtës për azil në Republikën e Maqedonisë dhe se nuk u është mundësuar qasja zyrtare përfaqësuesve të Shoqatës së Juristëve të rinj për t'i mësuar lidhur me të drejtat e tyre.

Nga biseda e realizuar me disa persona të vendosur në tend, janë marrë të dhëna tejet shqetësuese, të cilat tregojnë për faktin se personat të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë pranë personave të autorizuar zyrtarë të Ministrisë për Punë të Brendshme kanë deklaruar qartë synimin për paraqitjen e kërkesës për pranimin e të drejtës për azil, janë refuzuar me arsyetim se, një e drejtë e tillë nuk u takon në Republikën e Maqedonisë dhe se të njëjtën mund ta realizojnë pas deportimit, përkatësisht në shtetin prej të cilit kanë hyrë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Nga bisedat me personat e hasur në tendin e „Habitat”-it morëm informata se, paraprakisht, para se të vendosen në tend fotografohen dhe u merren vetëm të dhënat bazë personale nga ana e zyrtarëve të Ministrisë për Punë të Brendshme, dhe mëpas, pa kurrfarë procedure zyrtare dhe pa udhëheqjen e ndonjë evidence zyrtare, personat menjëherë deportohen në territorin prej nga kanë hyrë në mënyrë të paligjshme në Republikën e Maqedonisë.

Si rezultat i kësaj situatë faktike, Mekanizmi parandalues nacional konstatoi se pamundësia e qasjes pranë procedurës për pranimin e të drejtës për azil të personave të vendosur në tendin e „Habitat”-it, në mënyrë të drejtpërdrejtë tregon shkeljen flagrante dhe mosrespektimin e të drejtave të kësaj kategorie të personave të cilat i kanë të garantuara me ligjet kombëtare dhe aktet ndërkombëtare.